



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenin 22 paragrafi 7 në lidhje me nenit 73 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta zyrtare e Republikë së Maqedonisë, numër 12/2019 dhe nenit 40 paragrafi 4 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në senacën e 46-të të mbajtur me datë 12.02.2021, KSHPK morri

VENDIM

Është konstatuar shkelje e nenin 73 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave nga ana e personit, ish drejtor në SHFK Qendra e Zhupës.

Të ngritet procedurë për kundërvajtje kundër personit, në përputhje me nenin 107 paragrafi 1 alinea 2 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave në lidhje me nenin 73 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

SQARIM

Lënda me numër 09-5504/1 me datë 03.12.2019 është formuar në bazë të denoncimit nga parashtrues i panjohur, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, kundër personit ish drejtor në SHFK Qendra e Zhupës.

Parashtruesi në denoncim tregon se si drejtori i SHFK ka nënshkrua kontratë për punësim në kohë të pacaktuar me personit, edhe pse ka pasur nip nga vëllau.

Përveç kësaj, vëllau e tij e ka emëruar si ndihmës drejtor në shkollën

Përshkak të përcaktimit të gjendjes faktike dhe vërtetimit të akuzave në denoncim, Komisioni shtetëror u drejtua deri tek SHFK, në Qendrën e Zhupës dhe dorëzoi Kërkesë për mbledhje të të dhënave dhe informacioneve në lidhje me atë se vallë personi dhe janë të punësuar në SHFK, dhe nëse janë të dorëzohet dokumentacioni i plotë nga procedura e zhvilluar për punësim, prej kur janë të punësuar dhe në cilin vend të punës i kryejnë detyrat e veta të punës.

Në afatin e caktuar me ligj SHFK i dorëzoi informacionet e kërkuara dhe e ka informuar Komisioni shtetëror se personi dhe janë të punësuar në SHFK, dhe atë si mësues i gjeografisë i punësuar në vitin 2012 në kohë të caktuar, mirëpo të njëjtit i është transformuar marrëdhënja e punës në kohë të pacaktuar me 29.08.2019.

Të dy personat për të cilët flet denoncimi janë të afërm me drejtorit, gjegjësisht është nipi nga vëllau, kurse është vëllau.

Për rastin e parë, nga dokumentacioni i dorëzuar është vërtetuar se drejtori i shkollës i ka siguruar pëlqimet e nevojshme në lidhje me mjetet e nevojshme financiare, si dhe pëlqimin për punësim në kohë të pacaktuar në bazë të nevojës të përhershme të shkollës për punëtorë,

prandaj në bazë të asaj marrëdhënja e punës së i është transformuar në kohë të pacaktuar.

Mirëpo, edhe përkaj sigurimit të pëlqimit, drejtori i shkollës ka nënshkruar kontratën në kohë të pacaktuar me personin me datë 29.08.2019, edhe pse ai është nipi nga vëllau, pa lajmëruar paraprakisht interesin privat dhe të përjashtohet nga nënshkrimi i kontratës, me çka me atë ka shkelur nenin 73 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Në bazë të nenin 114 paragrafi 3 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror personit të emëruar i ka shqiptuar dhe i ka dorëzuar urdhër-pagesë për kundërvajtje për shkelje të nenin 73 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, dënuar sipas nenin 107 paragrafi 1 alinea 2 nga ligji i njëjtë.

Në rastin e dytë gjatë veprimit për emërim të ndihmës drejtorit të shkollës, nuk është vërtetuar shkelje e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të inteersave. Drejtori i atëhershëm i shkollës e ka autorizuar kryetarin e këshillit të shkollës të nënshkruan kontratë për avansim të, vëllau i tij.

Në bazë të të gjithë të përmendurës më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

**KOMISIONI SHTETËROR PËR
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT**

Kryetarë: Biljana Ivanovska

Pas përfundimit të KSHPK

Përpunoi: S. M., bashkëpunor i lartë

Miratoi: m-r Sh. S., anëtar i KSHPK